

VENDIM
Nr. 331, datë 2.6.2021

**PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË STATUSIT NGA KATEGORIA E
RESURSIT “TOKË BUJQËSORE” NË “TOKË URBANE”, TRUALL, TË PASURISË
ME NUMËR 1/68, ZONA KADASTRALE 3529, BASHKIA POGRADEK**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 11/1, të ligjit nr. 8752, datë 26.3.2001, “Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e ndryshimit të statusit, nga kategoria e resursit “tokë bujqësore” në “tokë urbane”, truall, të sipërfaqes prej 4 700 m², pjesë e pasurisë me numër 1/68, zona kadastrale 3529, Bashkia Pogradec, sipas certifikatës të pasurisë, hartës treguese dhe lidhjes nr. 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Drejtoria e Administrimit dhe e Mbrojtjes së Tokës, qarku Korçë, të pasqyrojë në dokumentacionin kadastral (LN) ndryshimin e resursit nga “tokë bujqësore” në “tokë urbane”, truall, të pasurisë me numër 1/68, zona kadastrale 3529, Bashkia Pogradec.

3. Agjencia Shtetërore e Kadastrës të bëjë ndryshimin e llojit të pasurisë, në certifikatën e pasurisë, sipas të dhënave për pasurinë e përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi.

4. Ngarkohen Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Qarkut Korçë dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe